



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Blerina Huruglica</b>	<b>10.04.2025</b>	<b>22.04.2025</b>	<b>2025/0241</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.04.2025, OE **“CONSTRUMAX SH.P.K.”**- Suharekë, ka parashtruar ankesë me nr: **2025/0241**, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Ndertimi i Institucionit Korrektues dhe Qendres se Paraburgimit ne Prizren”** me nr. të prokurimit: **"33600-24-13625-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **5,505,000.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

**Neni 1 i LPP-së**

**Neni 7 i LPP-së**

**Neni 18 i LPP-së**

**Neni 59 i LPP-së**

**Neni 60 i LPP-së**

## Neni 62 i LPP-së

### Neni 13 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

### Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

### Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Të nderuar me dt. 18.03.2025 ne kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku e ka anuluar aktivitetin e prokurimit, ndërsa neve na ka dërguar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Nuk keni ofruar dëshmi për kërkesat:

**Nuk i përmbushni këto kritere:**

Nuk e keni plotësuar kërkesën 1 të DT te kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme ndërtim i lartë brenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë. Kontratat e paraqitura (natyrës se ngjashme) duhet të paraqesin vlerën e se paku 7,000,000.00 Euro. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit – Kontratat e përfunduara të cilat janë prezantuar në listën e projekteve nuk e arrijnë vlerën e kërkuar në dosje të tenderit, shumica e kontratave nuk janë ndërtime të larta, janë renovime dhe si të tilla nuk mund të pranohen.

Nuk e keni plotësuar kërkesën 6. të DT – Nuk keni ofruar dëshmi se inxhinieri Lorik Dervishaj ka përvojë pune 7 vite pas diplomimit.

Nuk e keni plotësuar kërkesën 8. të DT – Nuk keni ofruar dëshmi se inxhinieri Petrit Haziri nuk ka përvojë pune 7 vite pas diplomimit.

Nuk e keni plotësuar kërkesën 9. të DT – Nuk keni ofruar dëshmi se inxhinieri Gazmend Krasniqi nuk ka përvojë pune 7 vite pas diplomimit.

Fillimisht ju sqarojmë se ne kemi pasur qasje në dokumentet e tenderit dhe dokumentet e OE ofertues, ku me dt.21.03.2025 na është lejuar qasja në dokumente.

Në lidhje me arsyet e AK-së për eliminimin tonë, ju sqarojmë se të njëjtat janë të pa bazuara dhe për këtë gjë do të prezantojmë faktet si në vijim:

1.Në lidhje me arsyen e parë të eliminimit tonë ku është cekur se kinse ne nuk kemi prezantuar kontrata të natyrës së ngjashme në vlerën e kërkuar, ju sqarojmë se e njëjta është e pa bazuar.

Kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë “1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se **ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme ndërtim i lartë mbrenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë.** Kontratat e paraqitura (natyrës se ngjashme) duhet të paraqesin vlerën e se paku 7,000,000.00 Euro. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “1. Një listë (tabelë) e cila paraqet kontratat të ngjashme të përfunduara mbrenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë duhet të paraqesin vlerën e se paku 7,000,000.00 Euro, kontrata të natyrës se ngjashme duhet të specifikohet data e përfunduar, lloji i punëve të përfshirë, pranuesi i punëve, shumat financiare e kontratës, ku për secilin punë të paraqitur në listë duhet të këtë Dëshmi me shkrim (Referencë ose Certifikatë përfundimtare ose Raport pranimi teknik të punës). Për

*investitor privat kerkohet deshmi si faturë tatimore apo transaksione bankare”.*

Autoriteti kontraktues nuk i ka analizuar në tërësi dëshmitë e prezantuara nga ana jonë si referencat dhe kontratat, pasi që të njëjtat kategorizohen tek ndërtimet e larta duke përfshirë këtu edhe renovimet, sepse edhe renovimet hyjnë në kuadër të sektorit të ndërtimit.

Tek lista e projekteve të Construmax SHPK është evidentuar lista e projekteve si në vijim:

REKAPITULLIM		
I	Lista e projekteve të realizuara gjatë vitit 2011	24,631.25 €
II	Lista e projekteve të realizuara gjatë vitit 2012	303,980.34 €
III	Lista e projekteve të realizuara gjatë vitit 2013	324,682.51 €
IV	Lista e projekteve të realizuara gjatë vitit 2014	405,136.87 €
V	Lista e projekteve të realizuara gjatë vitit 2015	159,483.67 €
VI	Lista e projekteve të realizuara gjatë vitit 2016	958,567.52 €
VII	Lista e projekteve të realizuara gjatë vitit 2017	759,972.32 €
VIII	Lista e projekteve të realizuara gjatë vitit 2018	1,814,667.36 €
IX	Lista e projekteve të realizuara gjatë vitit 2019	2,588,110.57 €
X	Lista e projekteve të kontraktuara gjatë vitit 2020	1,811,217.34 €
XI	Lista e projekteve të kontraktuara gjatë vitit 2021	1,562,078.30 €
XII	Lista e projekteve të kontraktuara gjatë vitit 2022	4,132,955.41 €
XIII	Lista e projekteve të kontraktuara gjatë vitit 2023	4,789,577.87 €
XIV	Lista e projekteve të kontraktuara gjatë vitit 2024	13,812,139.28 €
GJITHSEJ:		33,447,200.61 €

**Për projektet të cilat i kemi përfunduar ne kemi bashkangjitur në ofertë Referenca dhe procesverbale të punimeve të kryera për projektet e mëposhtme:**

Emri i projektit	Vlera e kontratës	Autoriteti kontraktues	
Projekt me bashkfinancim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë ritender’’	2,712,712.71€	Komuna e Suharekes dhe MKRS-ja	27.01.2025
Punimet shtese për „Projekt me bashkëfinancim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ritender’’	270,926.04€	Komuna e Suharekës dhe MKRS-ja	27.01.2025
Integrate Water Resource Management in Kosovo	549,452.60	Skat	25.09.2023
Ndërtimi I 1(një) Impianti për trajtimin e Ujërave të Zeza në Fshatin "Orllan" në Komunën e Podujevës : Faza 2 nga 2. RITENDER	404,222.57 €	CDI	20.06.2022
Ndërtimi i stacionit të pompimit dhe elementeve përcjellëse për funksionalizimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	145,171.00	CDI	22.09.2022
Koogjenerimi -Faza e parë e ndërtimit të sistemit të koogjenerimit për ngrohjen e qytetit të Obiliqit	917,917.91	Kuvendi Komunal Obiliq	22.12.2022
Ndërtimi i objektit te QKMF ne Mamushë	757,575.60	Ministria e Shendetësisë	21.11.2023
Ndërtimi i sallave të edukatës fizike në SHFMU Abdurraman Gërguri Dardhishë dhe SHFMU Dr.Ibrahim Rugova Mazgit i Lartë	1,088,088.00	Komuna e Obiliqit	08.11.2023
Ndërtimi I objektit të ri shkollorë Zef Lush Marku në Vlezhë faza e tretë	142,187.14	Komuna e Prizrenit	17.05.2022
Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER)-Lot 4	904,738.34	Millennium Foundation Kosovo	25.01.2023

Amendment No.1 for contract no RFQ/2022/No.005 for Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER)-Lot 4	340,724.97	Millennium Foundation Kosovo	25.01.2023
Construction/Renovation Works ar General Hospitals Gjilan and Prizren-Lot 2 General Hospital Prizren	142,548.37	Lux Development	21.07.2023
Amendment No1 Construction/Renovation Works ar General Hospitals Gjilan and Prizren-Lot 2 General Hospital Prizren	54,779.73	Lux Development	21.07.2023
Renovimi I Bibliotekës në qytetin e Shtimës -Ritender	378,378.00	MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK,	28.12.2023
Punë shtesë në Renovimin e Bibliotekës se Qytetit të Shtimës	37,691.50 €	MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK,	28.12.2023
Ndërtimi I objektit të SHFMU në Samdarxhë-Suharekë(faza e parë)	362,362.36	Ministria e Arsimit	2023
Renovimi I sallës në Qendren e Kopetencës në Malishevë	148,787.88	AAAPARR	28.03.2025
Ndërtimi i aneksit te objektit shkollorë „Dy Deshmoret” ne fshatin Serbice – Prizren dhe annex kontrates	138,123.22 euro 12,202.10 euro	Komuna e Prizren	06.12.2021
Ndërtimi I qerdhës se femijeve ne fshatin Sllovi dhe aneks kontrata	146330.15 € 9524.09 €	Komuna e Lipjanit	28.12.2022
Renovime tjera....	.....		
	<b>9,366,042.00€</b>		

Nga lista e lartcekur e të cilës listë i kemi bashkangjitur edhe dëshmitë e punëve të kryera në ofertën e dorëzuar nga ne, shihet qartë se vlera e referencave është mbi 9 milion euro, ndërsa gjithashtu në ofertë ne kemi dorëzuar edhe disa referenca në lidhje me infrastrukturë, drenazhim, renovime, mirëmbajtje, e të cilat projekte e tejkalojnë vlerën 10 milion euro.

Autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk i ka analizuar në detaje dokumentet e prezantuara nga ana jonë, kurse po të analizoheshin në detaje dokumentet tona, atëherë shumë qartë do të kuptohej se ne jo vetëm që e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit në lidhje me vlerën e kontratave të përfunduara, mirëpo edhe e tejkalojmë atë.

Po ashtu theksojmë se në listën tonë të projekteve të përfunduara janë përfshirë edhe punë të kryera në bashkëfinancime me institucione shtetërore dhe ndërkombëtare, të cilat përveç vlerës së lartë financiare, dëshmojnë kapacitetin tonë të dëshmuar në menaxhim, realizim dhe përmbyllje të suksesshme të projekteve të ndërlikuara dhe me rëndësi strategjike. Në këtë kontekst, ne konsiderojmë se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së, duke mos kryer vlerësim të detajuar, gjithëpërfshirës dhe të dokumentuar mbi dokumentacionin që dëshmon përvojën tonë të mëparshme.

Andaj kërkojmë nga OSHP-ja që të analizohen në tërësi dokumentet e prezantuara nga ana jonë (kontratat, referencat dhe procesverbalet e pranimit) dhe në fund të nxjerret një përfundim i saktë në lidhje me dëshmitë tona dhe jo të lejohet që AK-së të na eliminojë me arsyetime të tilla të pa bazuara.



2. Në lidhje me arsyet e eliminimit për inxhinierët z. L. D., z. P. H. dhe z. G. K. ku është cekur që të njëjtit nuk e plotësojnë përvojën prej 7 viteve punë pas diplomimit, ju sqarojmë se edhe kjo arsye është e pa qëndrueshme.

Për inxhinierët e lartcekur ne i kemi prezantuar dëshmitë e kërkuara sipas dosjes së tenderit dhe nëse të njëjtat analizohen në tërësi, atëherë shumë qartë kuptohet se inxhinierat e prezantuar nga ana jonë e plotësojnë kërkesën në lidhje me përvojën prej 7 viteve punë. Kërkojmë nga OSHP-ja që dëshmitë e ofruara nga ne, të vlerësohen drejtë sepse me këtë vlerësim të AK-së ne jemi diskriminuar, prandaj për të mos iu bashkangjitur me ankesë dëshmitë e tilla po iu inkurajojmë që të shikoni me kujdes dëshmitë e ofruara nga ne dhe më pastaj të vini në përfundim të drejtë dhe të saktë ju si institucion i pavarur.

Kërkesa 6 e DT lidhur me Inxhinieri i Hidro teknikes z.L.D. ka diplomuar ne vitin 2016 dhe është prezantuar ne CV e tije përvoja nga 2016 deri 2024 qe ka dëshmi mbi 9 vite përvojë profesionale, te mbështetura me dokumentacion te kërkuar ne DT

Kërkesa 8 e DT lidhur me Inxhinierin i Elektro-energjetikes z.P.H. ka diplomuar ne vitin 2009 dhe është prezantuar ne CV e tije përvoja nga 2009 deri 2024 qe ka dëshmi mbi 16 vite përvojë profesionale, te mbështetura me dokumentacion te kërkuar ne DT

Kërkesa 9 e DT lidhur me Inxhinieri i makinerisë z.G.K. ka diplomuar ne vitin 2014 dhe është prezantuar ne CV e tije përvoja nga 2014 deri 2024 qe ka dëshmi mbi 10 vite përvojë profesionale, te mbështetura me dokumentacion te kërkuar ne DT

Po ashtu nëse eventualisht AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me inxhinierët e prezantuar nga ana jonë, atëherë e njëjta ka mundur dhe është dashur të kërkojë sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

AK nuk ka përdorur të drejtën që i ofron neni 59.2 dhe neni 72 i LPP-së për të kërkuar sqarime plotësuese ose dokumente shtesë. Ky mosveprim përbën një shkelje të drejtpërdrejtë të obligimit për vlerësim të drejtë dhe të plotë të ofertës, ashtu siç kërkohet nga neni 7 i LPP-së për trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues të të gjithë operatorëve ekonomik.

Ne, në ofertë kemi bashkangjitur edhe dëshmi për inxhinier të tjerë të drejtimeve të cilat i ka kërkuar autoriteti kontraktues, andaj AK-ja është dashur ti shfrytëzojë të gjitha dispozitat ligjore duke kërkuar sqarime shtesë me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe jo të na eliminojë duke na diskriminuar neve si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në të drejtën tonë të garantuar nga neni 108/A dhe 109 i LPP-së, dhe në përputhje me qëllimin themelor të Ligjit për Prokurimin Publik – që është garantimi i trajtimit të barabartë, konkurrencës së ndershme dhe përdorimit të efektshëm të fondeve publike – ne konsiderojmë se eliminimi i grupit tonë është bërë në mënyrë të padrejtë, diskriminuese dhe pa bazë ligjore apo faktike.

3.Në lidhje me arsyen e AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ku e njëjta e ka cekur se anulimi i aktivitetit të prokurimit bëhet edhe për shkak të tejkalimit të vlerës së parashikuar të tenderit, ju sqarojmë se ky arsyetim është i paqëndrueshëm, sepse kur analizohet paramasa dhe parallogaria e këtij aktiviteti të prokurimit kuptohet qartë se vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit në krahasim me punët të cilat do të kryhen në këtë aktivitet të prokurimit nuk janë

në përputhje me njëra tjetrën, pasi që vlera e parashikuar është shumë e ulët.

Nga analiza e paramasës dhe punëve të cilat duhet të kryhen dhe nga analiza e çmimeve të tregut për këto punë të përcaktuara në paramasë rezulton se vlera e parashikuar është bërë shumë gabim dhe shumë e ulët, kurse oferta jonë është shumë e përafërt me çmimet e tregut. Se parashikimi i vlerës për këtë tender është i pasaktë dhe shumë i ulët e tregon fakti edhe nga ofertat financiare të kompanive të tjera ofertuese. Ne nuk jemi bazuar në vlerën e parashikuar të tenderit por në çmimet reale të tregut kur kemi ofertuar, prandaj nuk duhet të pësojmë ne si kompani nëse është përcaktuar gabimisht apo në mënyrë të ngutshme vlera e parashikuar e tenderit. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të tenderit nuk është respektuar neni 13 i RRPP Nr.001/2022, ku në paragrafin 1 ceket si në vijim:

*“Vlera e parashikuar e një kontratë publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar.13.3 Në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim”.*

Ne edhe pse kemi kërkuar në qasje vlerën e parashikuar nga projektuesi, për të cilën nuk na është ofruar qasje, jemi shumë kureshtar të dijmë se a është nxjerr ndonjë vlerë e përafërt nga projektuesi në këtë rast sepse zyra e prokurimit nuk është shumë kompetente për të analizuar çmimet e tregut dhe të përcaktojë vlerën e përafërt të parashikuar. Duhet te theksojmë qe ky projekt ka qene i planifikuar qe te përfundoj brenda 4 viteve, ku AK mundet gjate këtyre viteve te rishikoj buxhetin dhe te ndaj mjete apo te ndaj edhe ne faza sipas ndarjeve buxhetore. Ne vendimin refuzues është potencuar „që është menduar qe te kërkojmë mjete shtese nga Ministria e Financave për mbulimin e këtij projekti mirëpo me qenë se vlera është shume e larte nuk kemi hasur ne mirëkuptim ne sigurimin e këtyre mjeteve”, ky potencim argumenton që ne kemi qenë të përgjegjshëm, po ashtu vetëm kan menduar, mirpo nuk kan zbatuar te gjitha mundësit ligjore për te kërkuar mundësit financiare për të financuare këtë projekt të rëndësis shtetërorë.

Është e papranueshme që mungesa e parashikimit adekuat buxhetor të përdoret si arsye për anulimin e aktivitetit të prokurimit, kur oferta jonë është në përputhje me realitetin e tregut dhe përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Ne vlerësojmë se ka pasur mungesë të planifikimit të duhur financiar nga ana e AK-së, gjë që bie ndesh me nenin 13 të Rregullores 001/2022 dhe nenin 62.2 të LPP-së, ku parashihen qartë rastet e justifikuara për anulim të aktivitetit. Në këtë rast, nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara me ligj për të arsyetuar anulimin, përfshirë mungesën e mjeteve, kur vetë AK ka planifikuar projektin për katër vite dhe ka pasur mundësi reale për ndarjen buxhetore graduale. Andaj vlera e ofertës tonë është reale në krahasim me punët të cilat janë përcaktuar të kryhen sipas paramasës së hartuar nga ana e autoritetit kontraktues.

Sa i përket arsyes së cekur për tejkalim të buxhetit, kjo është sqaruar se vlera e parashikuar ka qenë e planifikuar jo drejtë dhe jo në harmoni me çmimet e tregut, prandaj çdo vonesë në realizimin e këtij projekti mund të kushtojë edhe më shtrenjtë. Sa i përket arsyetimit se në kornizën afatmesme për projektet kapitale nuk posedojnë mjete për të mbuluar ofertën tonë, sqarojmë se kjo kontratë është kornizë dhe mund të ndryshojnë edhe planifikimet kapitale për vitet pasuese, mirëpo çka është e rëndësishme është fakti se çmimet e ofruar nga ne janë çmime të tregut dhe duhet te merren parasysh, e jo për një planifikim jo të drejtë të autoritetit kontraktues. Analizë ligjore mbi mbështetjen financiare shtesë në mungesë buxheti për projekte

me interes shtetëror Bazat ligjore: Ligji për Financat Publike dhe mbështetja buxhetore shtesë Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë parasheh mekanizma të qartë për mbështetje financiare shtesë kur një organizatë buxhetore has nevoja të paparashikuara. Neni 29 i këtij ligji lejon autoritetet që, në rast shpenzimesh urgjente ose të paparashikuara, të aplikojnë pranë Ministrisë së Financave për fonde shtesë. Kërkesa formale duhet të arsyetojë rrethanat që krijuan nevojën, arsyen pse ato nuk ishin parashikuar, destinimin e fondeve shtesë dhe cilat zëra buxhetorë mund të riduken për t’i krijuar hapësirë financiare kësaj nevoje. Pas shqyrtimit teknik nga departamenti përkatës, Ministri i Financave mund ta refuzojë ose miratojë (edhe pjesërisht apo me kushte) kërkesën brenda 15 ditëve, me miratim përfundimtar nga Qeveria. Vetëm pas ratifikimit nga Qeveria, autorizohet vënia në dispozicion e mjeteve shtesë për atë projekt. Ky proces i përshpejtuar siguron që për projekte me rëndësi të veçantë, autoriteti kontraktues ka mundësi ligjore të marrë mbështetje buxhetore shtesë në kohë relativisht të shkurtër. Po ashtu, legjislacioni financiar parasheh fleksibilitet në rialokimin e buxhetit ekzistues. Neni 30 i Ligjit për Financat Publike lejon transferimin e fondeve nga një ndarje buxhetore në tjetrën brenda të njëjtës organizatë, deri në 5% të vlerës, edhe pa miratim paraprak të Ministrisë. Me arsyetim të vlefshëm, Ministri mund të autorizojë transferime deri në 15% të një ndarje buxhetore, ndërsa për tejkalimin e kësaj përqindje kërkohet pëlqimi i Qeverisë apo Kuvendit, sipas rastit. Këto dispozita nënkuptojnë se një Autoritet Kontraktues (AK) mund të riprioritizojë shpenzimet e veta të planifikuara, për t’u siguruar që projekti i rëndësishëm të ketë financim të mjaftueshëm. Në rastin konkret, AK-ja (Shërbimi Korrektues i Kosovës) ishte në dijeni të mundësisë për të kërkuar fonde shtesë nga Ministria e Financave, gjë që edhe e ka përmendur në vendimin e tij. Sipas arsyetimit të autoritetit, “është menduar që të kërkojmë mjete shtesë nga Ministria e Financave për mbulimin e këtij projekti, mirëpo meqenëse vlera është shumë e lartë nuk kemi hasur në mirëkuptim në sigurimin e këtyre mjeteve”. Kjo do të thotë se AK-ja e ka konsideruar vetëm teorikisht këtë hap, por nuk rezulton të ketë ndjekur deri në fund procedurat formale që ligji ofron për përkrahje buxhetore. Ligji e obligon autoritetin që, para se të heqë dorë, të përdorë të gjitha mundësitë ligjore për sigurimin e financimit shtesë – dhe ekzistojnë prova se në këtë rast ato mundësi nuk u shfrytëzuan plotësisht. Thënë ndryshe, mungesa e mbështetjes financiare nuk ishte e pakapërcyeshme nga pikëpamja ligjore, pasi vetë korniza ligjore e financave publike i jep mundësi AK-së të kërkojë e të marrë fonde shtesë në projekte me rëndësi shtetërore. Fazimi i kontratës në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH)

Procedurat e planifikimit buxhetor afatmesëm në Kosovë mundësojnë që projektet kapitale të shpërndahen në financim shumëvjeçar. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) dhe Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) përfshijnë planet treditore të shpenzimeve, duke lejuar që projekte të mëdha 10/17 të financohen gradualisht, vit pas viti, pa e ngarkuar vetëm buxhetin e vitit të parë. Kontratat shumëvjeçare janë të lejuara me kusht që vlera e plotë e projektit të pasqyrohet në ligjin vjetor të buxhetit si projekt shumëvjeçar, dhe angazhimet përkatëse financiare të regjistrohen për periudhën trevjeçare sipas dinamikës së realizimit. Kjo do të thotë se një autoritet mund të nënshkruajë kontratë edhe nëse kostoja e saj e tejkalon buxhetin e vitit aktual, përderisa pjesët e mbetura të financimit janë planifikuar në buxhetet e viteve në vijim dhe janë miratuar si të tilla. Në këtë rast, projekti “Ndërtimi i Institucionit Korrektues dhe Qendrës së Paraburgimit në Prizren” ishte parashikuar të realizohej brenda 4 viteve. Vetë ky plan kohor sugjeron se financimi i projektit do të mbulohej në disa vite buxhetore (p.sh. ndarje vjetore për secilin nga 4 vitet). Pra, AK-ja e kishte menduar fazimin kohor të punimeve – një praktikë e zakonshme për projektet e mëdha infrastrukturore – por problemi lindi kur ofertat e pranuar e tejkaluan vlerën e parashikuar fillestare për vitin aktual. Zgjidhja logjike në këtë situatë do të ishte rishikimi i planit financiar afatmesëm, në mënyrë që diferenca e krijuar (ndryshimi mes



parashikimit fillestar dhe ofertës reale) të akomodohej në vitet e ardhshme. Duhet theksuar se planifikimi afatmesëm buxhetor obligon autoritetet që prokurimet t’i organizojnë në përputhje me fondet e miratuara dhe t’i integrojnë projektet në kuadrin shumëvjeçar financiar. Nëse AK-ja e kishte përfshirë saktë këtë projekt në Programin e Investimeve Publike dhe KASH 2023-2025 (dhe 2025- 2027), vlera totale e kontratës do të figuronte në ligjin e buxhetit dhe ai do të kishte mundësi ta nënshkruante kontratën duke u bazuar në financimin gradual. Ligji mbi buxhetin përcakton se një kontratë për projekt shumëvjeçar mund të nënshkruhet vetëm nëse shpenzimet për koston totale janë të parashikuara në ligjin e buxhetit dhe angazhimet shumëvjeçare janë regjistruar në sistemin financiar për periudhën treditore. Në praktikë, kjo nënkupton që Qeveria dhe Kuvendi kishin dhënë miratimin e tyre për ta realizuar projektin në fjalë brenda disa viteve me financim të ndarë. Phazimi i kontratës është një mekanizëm i rëndësishëm: në vend se projekti të anulohet për shkak të mungesës së gjithë shumës në vitin e parë, autoriteti mund ta niste realizimin me fondet e vitit aktual dhe të planifikonte rritjen e buxhetit për këtë projekt në vitet pasuese. Nëse oferta e pranuar ishte më e lartë se parashikimi, AK-ja mund të kërkonte nga Ministria e Financave rritjen e tavanëve buxhetore për vitet e ardhshme në KASH, në mënyrë që kontrata të përmbyllet me sukses brenda afatit katërvjeçar. Një projekt i fazuar në këtë mënyrë do të evitonte vonesat dhe koston shtesë të ri-tenderimit në të ardhmen, dhe do të ishte në përputhje me parimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike. Pra, në vend të anulimit, AK-ja kishte mundësi ta ridimensiononte financiarisht projektin brenda Kornizës Afatmesme. Edhe vetë AK-ja pranon në korrespondencën e tij se projekti mund të përfundonte brenda 4 viteve dhe se gjatë këtyre viteve “AK mundet të rishikojë buxhetin dhe të ndajë mjete apo të ndajë edhe në faza sipas ndarjeve buxhetore”. Kjo është pikërisht ajo që KASH lejon – ndarje në faza – dhe dështimi për ta bërë një gjë të tillë, pavarësisht se ishte e mundur, e bën anulimin e tenderit të pajustificuar. Bashkëfinancimi dhe rishikimet buxhetore si zgjidhje financiare Përveç kërkesës formale për fonde shtesë dhe fazimit shumëvjeçar, një alternativë tjetër për të adresuar mungesën e buxhetit është bashkëfinancimi ose rishikimi i buxhetit. Kjo nënkupton që autoriteti kontraktues mund të kërkojë burime shtesë financimi duke kombinuar fonde nga disa entitete ose duke bërë ndryshime në vetë Ligjin e Buxhetit gjatë vitit. Rishikimi (rebalance) i buxhetit gjatë vitit Në Kosovë, rishikimi i buxhetit është një praktikë e zakonshme kur dalin nevoja të reja ose të paplanifikuara. Qeveria obligohet shpesh të paraqesë në Kuvend një Ligj për rishikimin e buxhetit (zakonisht në mesin e vitit), me qëllim rialokimin e fondeve ose shtimin e tyre për projekte apo shpenzime 11/17 specifike. Një zyrtar i Ministrisë së Financave ka sqaruar se “rishikimi i buxhetit mundëson që mjetet e nevojshme të sigurohen në linjat e duhura buxhetore”, pra paratë mund të ekzistojnë, por duhet të ri-orientohen ligjërisht tek zërat përkatës. Me anë të rishikimit buxhetor, Qeveria dhe Kuvendi mund të vendosin të shtojnë fonde për një projekt me prioritet të lartë, edhe pse ai ka tejkaluar parashikimet fillestare. Në rastin konkret, nëse oferta fituese kërkon më shumë mjete sesa të planifikuara, Qeveria mund të propozonte që në rishikimin e buxhetit 2025 ose në buxhetin e vitit pasues të alokoheshin fondet shtesë për këtë projekt. Kjo do të siguronte vijimësinë e kontratës pa e penguar ligjërisht AK-në të nënshkruante marrëveshjen me operatorin fitues. Ligji vjetor i buxhetit mundëson përfshirjen e amendamenteve të tilla: p.sh., një shtesë në kategorinë e shpenzimeve kapitale të Ministrisë së Drejtësisë (nën të cilën bie Shërbimi Korrektues) e dedikuar për këtë projekt specifik. Një qasje e tillë do të ishte plotësisht e ligjshme dhe në harmoni me parimin që projektet me interes shtetëror nuk duhet të dështojnë për shkak të kufizimeve të përkohshme buxhetore. Bashkëfinancimi dhe mbështetja nga institucione të tjera Bashkëfinancimi nënkupton sigurimin e financimit nga më shumë se një burim. Për projekte madhore (si ndërtimi i objekteve korrektuese), autoriteti kontraktues mund të kërkojë mbështetje edhe nga institucioni mëmë ose partnerë të tjerë qeveritarë. P.sh., nëse Shërbimi Korrektues i Kosovës bie nën Ministrinë e Drejtësisë, atëherë

vetë Ministria mund të rialokojë fonde nga projekte të tjera më pak prioritare, ose të kërkojë fonde shtesë nga Qeveria për këtë projekt. Ligji i buxhetit njeh konceptin e granteve për mbështetje buxhetore – transferime nga një institucion tek tjetri për të mbuluar shpenzime buxhetore. Në praktikë, Qeveria e Kosovës ka marrë vendime edhe në të kaluarën për të ndarë mjete shtesë për projekte urgjente apo për ndërmarrje publike kur ka pasur nevojë emergjente. Për shembull, në vitin 2021 Qeveria aprovoi kërkesën e KOSTT-it (operatori i transmisionit elektrik) për ndarjen e mbi 6.6 milion € shtesë për mbulimin e kostove emergjente të energjisë. Kjo tregon se ekziston praktikë e ndihmës financiare ad-hoc nga Qeveria për të siguruar realizimin e detyrimeve apo projekteve me interes nacional. Në rastin tonë, AK-ja mund të kishte kërkuar një grant shtesë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Sipas Ligjit për Financat Publike, Ministri i Financave, me miratim të Qeverisë, mund të autorizojë shpenzime nga ndarja buxhetore e paparashikuar (fondi rezervë) për të mbuluar shpenzime urgjente. Një projekt i rëndësisë së veçantë shtetërore, siç konsiderohet ky burg, mund të argumentohet lehtësisht si kandidaturë për përdorimin e fondit rezervë (i cili ekziston pikërisht për situata ku projektet/shërbimet rrezikohen pa fajin e autoritetit, por për shkak të rrethanave jashtë parashikimit). Në përmbledhje, AK-ja kishte këto alternativa financiare përpara se të mendonte anulimin: (1) Rialokimi i brendshëm i mjeteve brenda buxhetit të vet (p.sh. shtyrja ose anulimi i ndonjë shpenzimi dytësor për të liruar fonde për projektin prioritar); (2) Kërkesa zyrtare për fonde shtesë/mbështetje buxhetore nga Ministria e Financave sipas nenit 29 të Ligjit (me arsyetimin se kostoja reale doli më e lartë se parashikimi fillestar); (3) Iniciimi i një rishikimi të buxhetit nga ana e Qeverisë specifikisht për këtë projekt, ose përfshirja e fondeve shtesë në buxhetin e vitit pasues; (4) Bashkëfinancimi/qasja tek fondi rezervë – pra sigurimi i mjeteve nga një institucion tjetër qendror (p.sh. nga vetë Qeveria ose Ministria mëmë). Të gjitha këto mundësi janë mjete ligjore dhe administrative në dispozicion të AK-së, të cilat synojnë pikërisht që mungesat financiare të mos pengojnë realizimin e projekteve të rëndësishme publike. 12/17 Fakti që autoriteti ka vetëm “menduar” të kërkojë fonde shtesë, por nuk ka ndjekur ndonjë nga hapat e mësipërm deri në fund, tregon se anulimi është bërë pa e shteruar fillimisht zgjidhjen e problemit financiar. Në një procedurë prokurimi, mungesa e buxhetit gjatë vlerësimit të ofertave nuk duhet të jetë shkak i menjëhershëm për anulim, por duhet trajtuar si një çështje për t’u zgjidhur përmes mekanizmave buxhetorë. Këto mekanizma ekzistojnë dhe janë aplikuar edhe në raste të tjera – mospërdorimi i tyre në këtë rast e bën vendimin e anulimit të paarsyeshëm. Status i veçantë i projektit dhe linja të dedikuara buxhetore Një opsion plotësues, i rrallë por i mundshëm, është që projekti të fitojë status të veçantë prioritar në rang shtetëror, në mënyrë që financimi i tij të sigurohet me vendim politik në nivelin më të lartë. Kur flitet për “projekt me interes të veçantë shtetëror”, nënkuptohet që ai projekt shihet si strategjik për vendin (p.sh. infrastruktura kritike, objekte të sigurisë kombëtare, etj.). Në raste të tilla, Qeveria mund të marrë masa të jashtëzakonshme për të garantuar zbatimin e projektit: mund të krijojë një zë specifik buxhetor për të, mund të propozojë një ligj të veçantë, ose mund ta përfshijë projektin në programe kombëtare zhvillimore me financim të siguruar. Shembulli i lartpërmendur i Maqedonisë së Veriut (ligji special për autostradat) është ilustrues i idesë së “statusit special”. Edhe në Kosovë, Qeveria ka hapësirë të shpallë një projekt si prioritet kombëtar përmes vendimeve strategjike. Kjo mund të bëhet, për shembull, duke e përfshirë projektin në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit apo në programin e investimeve kryesore, dhe më pas Kuvendi mund t’i ndajë fonde të posaçme. Në praktikë, kjo do të nënkuptonte krijimin e një linje të dedikuar buxhetore për zbatimin gradual të projektit. Një linjë e tillë do të siguronte financim shumëvjeçar dhe do ta mbronte projektin nga luhatjet vjetore buxhetore. Për projektin konkret (burgun e Prizrenit), duke qenë se lidhet me sistemin korrektues dhe sigurinë publike, mund të argumentohet lehtësisht se ka rëndësi shtetërore. Autoriteti kontraktues (përmes Ministrisë së

linjës) kishte mundësi t’i drejtohej Qeverisë për ta trajtuar këtë projekt si prioritet urgjent. Nëse, fjala vjen, Qeveria do ta cilësonte zyrtarisht ndërtimin e këtij institucioni si projekt prioritar për sistemin e drejtësisë, atëherë alokimi i fondeve shtesë do të bëhej shumë më i shpejtë dhe i garantuar. Linja buxhetore e dedikuar mund të formohej qoftë nëpërmjet rishikimit (si shtesë e veçantë për këtë projekt), qoftë në buxhetin e vitit pasues me emërtim specifik (p.sh. “Projekt i veçantë: Ndërtimi i Qendrës së Paraburgimit Prizren”). Një status i veçantë do t’i jepte gjithashtu autoritetit kontraktues fleksibilitet në ekzekutimin e kontratës. Për shembull, me miratim të Qeverisë, pagesat e kontratës mund të përparësoheshin (p.sh. një pjesë e madhe e fondit të paguhej vitin e dytë ose të tretë, kur buxheti do të mundësohej plotësisht). Gjithashtu, AK-ja do të kishte mundësi të negocionte me ofertuesin fitues për një skemë pagesash të shtyra apo të ndara sipas viteve, bazuar në garancinë se fondet do të vijnë (kjo sigurisht pasi të shpallej fituesi, gjatë negociimit të kontratës). Një projekt i rëndësisë shtetërore zakonisht gëzon prioritet edhe në listën e borxhit publik – nëse duhej, Qeveria mund të merrte një kredi specifike për ta mbuluar këtë investim, gjë që ligjërisht është më e lehtë kur projekti është i deklaruar si investim publik prioritar. Me fjalë të tjera, autoriteti kontraktues nuk ishte i vetëm në përpjekjen për të gjetur zgjidhje: ai kishte mundësinë të ngrinte çështjen në nivelin qeveritar dhe të kërkonte një zgjidhje strategjike. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) e di mirë që shumë projekte kapitale në Kosovë janë realizuar vetëm pasi u siguria mbështetje ndërinstitucionale. Për shembull, ndërtimi i objekteve të mëdha publike (spitale, universitete, burgje) shpesh ka përfshirë bashkëpunim ndërmjet ministrive dhe miratim të veçantë nga Qeveria për ndarjen e fondeve në disa vite. Ky projekt nuk bën përjashtim – përkundrazi, karakteri i tij i veçantë do të duhej ta shtynte AK-në të kërkonte me ngulm zgjidhje në instancat më të larta. Konkluzion 13/17 Nga analiza e mësipërme del qartë se Autoriteti Kontraktues kishte në dispozicion një sërë mjetesh ligjore dhe administrative për të siguruar financimin e nevojshëm shtesë për projektin, pavarësisht se ofertat e pranura tejkaluan buxhetin fillestar. Ligji për financat publike i jep mundësi çdo organizate buxhetore të kërkojë fonde shtesë në raste të jashtëzakonshme dhe të rialokojë buxhetin e vet, ndërsa korniza e buxhetimit afatmesëm lejon që projektet të realizohen me financim të fazuar në disa vite. Përveç këtyre, praktika e mirë qeveritare ofron instrumente si rishikimi i buxhetit, përfshirja e projekteve prioritare në buxhetet e ardhshme dhe bashkëfinancimi ndërinstitucional. Edhe krahasimi me vendet fqinje tregon se zgjidhja për mungesën e buxhetit nuk është anulimi i projektit, por mobilizimi i burimeve financiare shtesë përmes procedurave të posaçme. Në rastin konkret, vendimi për anulimin e tenderit me arsyetimin e vetëm të mungesës së mjeteve përbën shmangie nga këto mundësi. Autoriteti nuk paraqiti asnjë provë se ka bërë përpjekje formale për të siguruar mbështetje financiare (përtej “mendimit” verbal për të kërkuar fonde). Një veprim i tillë është i paarsyeshëm sepse injoron rrugët ligjore ekzistuese për zgjidhje, dhe i kundërligjshëm në frymën e ligjit, i cili kërkon nga autoritetet përdorimin e kujdesshëm dhe efektiv të fondeve publike. Të anulosh një projekt kaq të rëndësishëm vetëm sepse procedura e tenderimit zbuloi një nevojë financiare më të lartë, do të thotë të prishësh qëllimin për të cilin janë krijuar dispozitat financiare dhe buxhetore – pra, për t’i realizuar projektet publike duke kapërcyer sfidat financiare. Në dritën e gjithë sa më sipër, anulimi i aktivitetit të prokurimit vetëm për mungesë buxheti duhet shpallur i pabazuar. AK-ja kishte detyrimin që, për një projekt me interes shtetëror, të ndërmernte çdo hap të mundshëm për sigurimin e mjeteve – detyrim që rrjedh si nga legjislacioni financiar, ashtu edhe nga parimet e prokurimit publik (planifikim i saktë dhe ekonomizim i parasë publike). Mosshfrytëzimi i këtyre hapave dhe marrja e vendimit ekstrem të anulimit dëmton interesin publik dhe konkurrencën, prandaj Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet të konstatojë se ky vendim është i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me ligjin. AK-ja dispononte mjetet e nevojshme për të siguruar financimin – si në aspektin ligjor, ashtu edhe në atë administrativ – dhe dështimi për t’i përdorur ato nënkupton se anulimi nuk mund të

justifikohet si veprim i domosdoshëm. Për pasojë, ne kërkojmë nga OSHP-ja që ankesa jonë të pranohet, dhe të urdhërojë vijimin e procedurës së prokurimit me marrjen e masave për sigurimin e mbështetjes buxhetore sipas mundësive të parashikuara nga ligji. Ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e grupit të OE R&Rukolli & LIMORA SH.P.K., dhe se ato arsye të eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore. Ne me dt. 28.03.2025 kemi pranuar njoftimin e AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, mirëpo që arsyet e AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim janë të pa bazuara dhe njëkohësisht të pa mbështetura në ndonjë dispozitë ligjore. Në lidhje me arsyen e parë të eliminimit AK-së është përgjigjur si më poshtë:

### **Lidhur me pikën 1**

Kërkese në Dosjen e Tenderit është:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme **ndërtim i lartë** brenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftit për kontratë. Kontratat e paraqitura (natyrës së ngjashme) duhet të paraqesin vlerën e së paku 7,000,000.00 Euro. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Kontratat e përfunduara të cilat janë prezantuar në listën e projekteve të juaja nuk e arrijnë vlerën kërkuar në dosje të tenderit, shumica e kontratave nuk janë ndërtime të larta, janë renovime dhe s tilla nuk mund të pranohen.

Nga kjo përgjigje vërehet përsëri që nuk është ofruar asnjë dëshmi konkrete në lidhje me këtë arsye të eliminimit por AK-së vetëm ka qëndruar pranë konstatimeve të tyre. Edhe për arsyen e dytë të eliminimit është përsëritur i njëjti konstatim, vetëm se tani ceket edhe kinse stafi sipas pikës 14 nuk është i licencuar për saldim, mirëpo ky arsyetim është i pa bazuar për faktin se në DT nuk është kërkuar të jetë i licencuar mirpo i certifikuar për të cilin kemi ofruar dëshmi certifikatën e cila ka qenë kofdor Kërkesës nr 14 e DT: „Një baschelor apo Inxhinier i dip. ndërtimtarisë i certifikuar nga prodhuesi për saldim të hidroizolimeve nga PVC me përvojë së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas certifikimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare 14. Diploma, Certifikikata nga prodhuesi, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt dhe CV-në të nënshkruara nga inxhinieri dhe punëdhënsi - kopje origjinale Referencat për përvojën sipas kërkesës.” Kjo arsye është e pa bazuar ashtu siç është cekur më lartë, ndërsa tendenca që të orientohen edhe në pika të tjera, pa qenë arsye të eliminimit tregon për tendencë diskriminuese ndaj kompanisë tonë. Bazuar në dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), Autoriteti Kontraktues ka pasur në dispozicion një numër të madh mjetesh ligjore dhe administrative për të siguruar financimin e projektit edhe nëse vlera e ofertave të pranuarra e tejkalon vlerën e parashikuar fillestare. Në vijim paraqesim një analizë të detajuar të këtyre mundësive: 1. Mbështetja financiare shtesë nga Ministria e Financave (neni 29 i Ligjit për Financat Publike) Autoriteti Kontraktues kishte të drejtë të paraqiste kërkesë zyrtare për mbështetje shtesë buxhetore në Ministrinë e Financave, duke justifikuar nevojën emergjente ose të paparashikuar që kishte lindur pas vlerësimit të ofertave. Ky mekanizëm është i parashikuar me ligj pikërisht për situata ku fondet e planifikuara nuk janë të mjaftueshme për realizimin e një kontrate të rëndësishme publike. Mungesa e një kërkesë të tillë formale tregon se nuk është shfrytëzuar mundësia ligjore për zgjidhje të situatës së paraqitur. 2. Fazimi i projektit në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH/KAB) Ky projekt ishte planifikuar të realizohej brenda katër viteve. KASH i mundëson autoriteteve që të shpërndajnë shpenzimet kapitale në periudha shumëvjeçare, duke lejuar që vlera totale e kontratës të ndahet në vite të ndryshme buxhetore. Kjo do të thotë se



AK-ja kishte hapësirë që projektin ta financojë në faza dhe të kërkojë rritje të tavaneve buxhetore për vitet pasuese për të përmbyllur kontratën. 3. Rishikimi i buxhetit (rebalance) dhe përfshirja në buxhetin e viteve të ardhshme Qeveria e Kosovës aplikon praktikën e rishikimit të buxhetit (zakonisht në mes të vitit) për të përfshirë projekte të reja apo për të shtuar fonde në projekte ekzistuese. Për një projekt me interes shtetëror si ky, AK-ja ka pasur mundësi të propozojë përfshirjen e mjeteve shtesë në rishikimin e buxhetit ose të kërkojë përfshirjen e linjës buxhetore të dedikuar në buxhetin e vitit të ardhshëm. 15/17 4. Përdorimi i fondit rezervë dhe mbështetja ndërinstytucionale (grante transferuese) Ligji për Financat Publike lejon përdorimin e fondit rezervë të Qeverisë për mbulimin e projekteve të paparashikuara ose urgjente. Një projekt i tillë, që ndërlidhet me sistemin korrektues dhe sigurinë kombëtare, mund të klasifikohet me lehtësi si kandidaturë për këtë fond. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë, si ministri mëmë, mund të siguronte bashkëfinancim për këtë projekt përmes rialokimit të mjeteve nga linja të tjera buxhetore. 5. Praktikrat rajonale dhe krahasimi me vendet e tjera Në vendet e rajonit si Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, anulimi i tenderëve për shkak të mungesës së buxhetit është masë ekstreme dhe e jashtëzakonshme. Në raste të projekteve madhore, autoritetet zakonisht kërkojnë fonde shtesë, e ndajnë projektin në faza ose aplikojnë për financim alternativ, në vend që ta braktisin tërësisht projektin. Rasti i linjës 400kV Shqipëri-Kosovë, projekti i autostradave në Maqedoninë e Veriut dhe projektet energjetike në Mal të Zi tregojnë se zgjidhjet për sfidat financiare janë të mundshme përmes vullnetit institucional. 6. Statusi i veçantë i projektit dhe linjat buxhetore të dedikuara Ky projekt lidhet me infrastrukturën korrektuese të Kosovës dhe përbën një investim me rëndësi shtetërore. AK-ja kishte të drejtë të kërkonte status të veçantë për projektin, i cili do të mundësonte krijimin e një linje të dedikuar buxhetore dhe sigurimin e fondeve për zbatim shumëvjeçar. Përmes përfshirjes në programin e investimeve kombëtare ose në një vendim të posaçëm të Qeverisë, projekti do të mund të mbështetej në mënyrë të garantuar. PËRFUNDIM Duke marrë parasysh mjetet dhe mundësitë e përshkruara më sipër, konkludojmë se Autoriteti Kontraktues nuk i ka shfrytëzuar mjetet ligjore dhe administrative që i kishte në dispozicion për sigurimin e financimit shtesë për këtë projekt. Vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin e mungesës së buxhetit është i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me frymën e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Ligjit për Financat Publike. Prandaj, kërkojmë nga OSHP-ja që të konstatojë se anulimi është bërë në kundërshtim me ligjin dhe të urdhërojë vijimin e procedurës së prokurimit, me masat përkatëse për sigurimin e fondeve për realizimin e projektit. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, e po ashtu nuk është respektuar fare neni 60 i LPP-së. Pra duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë. Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, 16/17 duke mos na rekomanduar për kontratë edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe kemi ofertuar me çmim më të ulët. Po ashtu nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe



dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr: **V E N D I M APROVOHET**, ankesa e GOE “Construmax sh.p.k. & Harst Group SH.P.K si e bazuar **ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM, DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## KRITERET PËR VLERËSIM

### Kërkesat 9.1&9.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme ndërtim i lartë mbrenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë. Kontratat e paraqitura (natyrës se ngjashme) duhet të paraqesin vlerën e se paku 7,000,000.00 Euro. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e punëve të përfunduara kërkohe për liderin e grupit.**

#### Dëshmia:

**1. Një listë (tabelë) e cila paraqet kontratat të ngjashme të përfunduara mbrenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë duhet të paraqesin vlerën e se paku 7,000,000.00 Euro, kontrata të natyrës se ngjashme duhet të specifikohet data e përfunduar, lloji i punëve të përfshirë, pranuesi i punëve, shuma financiare e kontratës, ku për secilin punë të paraqitur në listë duhet të këtë Dëshmi me shkrim (Referencë ose Certifikatë përfundimtare ose Raport pranimi teknik të punës). Për investitor privat kerkohet deshmi si faturë tatimore apo transaksione bankare.**

**6. Një Inxhinier apo Master i dip. i Hidroteknikës - së paku 7 vite përvojë pune profesionale ( pas diplomimit).**

#### Dëshmia:

**6.Diploma (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master), certifikata, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt dhe CV-në të nënshkruara nga inxhinieri dhe punëdhënsi - kopje origjinale referencat për përvojën sipas kërkesës.**

**8. Një Inxhinier apo Master i dip. i Elektrotos drejtimi energjetik - së paku 7 vite përvojë pune profesionale ( pas diplomimit). Te jete i certifikuar për auditimin e energjisë në ndërtesa.**

#### Dëshmia:

**8. Diploma (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master), certifikata, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt dhe CV-në të nënshkruara nga inxhinieri dhe punëdhënsi - kopje origjinale Referencat për përvojën sipas kërkesës.**

**9. Një (1) Inxhinier apo Master i dip.i Makinerisë\_Drejtimi Termoenergjetikë së paku 7 vite përvojë përvojë pune profesionale ( pas diplomimit). Te jete i certifikuar për auditimin e energjisë në ndërtesa.**

**Dëshmia:**

**9.Diploma (fakulteti sipas sistemit 5 vjeçar ose master), certifikata, kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt dhe CV-në të nënshkruara nga inxhinieri dhe punëdhënsi - kopje origjinale Referencat për përvojën sipas kërkesës.**

**RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES**

**ARSYETIM - Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :**

**Nuk keni ofruar dëshmi për kërkesat:**

**Nuk i përmbushni këto kritere:**

**Nuk e keni plotësuar kërkesën 1 të DT te kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme ndërtim i lartë brenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë. Kontratat e paraqitura (natyrës së ngjashme) duhet të paraqesin vlerën e se paku 7,000,000.00 Euro. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e punëve të përfunduara kërkohej për liderin e grupit – Kontratat e përfunduara të cilat janë prezantuar në listën e projekteve nuk e arrijnë vlerën e kërkuar në dosje të tenderit, shumica e kontratave nuk janë ndërtime të larta, janë renovime dhe si të tilla nuk mund të pranohen.**

**Nuk e keni plotësuar kërkesën 6. të DT – Nuk keni ofruar dëshmi se inxhinieri Lorik Dervishaj ka përvojë pune 7 vite pas diplomimit.**

**Nuk e keni plotësuar kërkesën 8. të DT – Nuk keni ofruar dëshmi se inxhinieri Petrit Haziri nuk ka përvojë pune 7 vite pas diplomimit.**

**Nuk e keni plotësuar kërkesën 9. të DT – Nuk keni ofruar dëshmi se inxhinieri Gazmend Krasniqi nuk ka përvojë pune 7 vite pas diplomimit.**

**e një trajnimi në përdorimin e materialeve izoluese.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

**INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK**

/

#### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

/

#### VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

#### ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

#### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - CONSTRUMAX SH.P.K.

Aktiviteti i prokurimit me titull: “**Ndërtimi i Institucionit Korrektues dhe Qendrës së Paraburgimit në Prizren**” me nr. të prokurimit: “**33600-24-13625-5-1-1**”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**, procedurë te hapur, lloji i kontratës pune, kriteri çmimi i ulët i përgjegjshëm.

AK me datë 18/03/2025 anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin si më poshtë:

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Shërbimi Korrektues i Kosovës e anulon aktivitetin e prokurimit pasi që ofertat e pranuar janë të pa përgjegjshme sipas kërkesave të dokumenteve të njoftimit për kontratë dhe në dosje të tenderit si dhe kanë çmim më të lartë se vlera e parashikuar e kontratës

Gjithashtu në letrën standarde OE ankuesin eliminon po ashtu me arsyetimin:

**ARSYETIM - Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :**

**Nuk keni ofruar dëshmi për kërkesat:**

**Nuk i përmbushni këto kritere:**

**Nuk e keni plotësuar kërkesën 1 të DT te kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme ndërtim i lartë brenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë. Kontratat e paraqitura (natyrës se ngjashme) duhet të paraqesin vlerën e se paku 7,000,000.00 Euro. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit – Kontratat e përfunduara të cilat janë prezantuar në listën e projekteve nuk e arrijnë vlerën e kërkuar në dosje të tenderit, shumica e kontratave nuk janë ndërtime të larta, janë renovime dhe si të tilla nuk mund të pranohen.

**Nuk e keni plotësuar kërkesën 6. të DT – Nuk keni ofruar dëshmi se inxhinieri Lorik Dervishaj ka përvojë pune 7 vite pas diplomimit.**

**Nuk e keni plotësuar kërkesën 8. të DT – Nuk keni ofruar dëshmi se inxhinieri Petrit Haziri nuk ka përvojë pune 7 vite pas diplomimit.**

**Nuk e keni plotësuar kërkesën 9. të DT – Nuk keni ofruar dëshmi se inxhinieri Gazmend Krasniqi nuk ka përvojë pune 7 vite pas diplomimit.**

## **e një trajnimi në përdorimin e materialeve izoluese.**

Rrjedhimisht, OE ankues i pakënaqur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i njëjti parashtron ankesë në OSHP duke pretenduar se AK vlerësimin e ofertave e ka zhvilluar në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik përkatësisht nenet:1,7,18,59,60,62, dhe Rregulloren për Prokurim Publik nr.001/2022 nenet 13,40,43.

**Pretendimi i parë i OE ankues:**

*1.Në lidhje me arsyen e parë të eliminimit tonë ku është cekur se kinse ne nuk kemi prezantuar kontrata të natyrës së ngjashme në vlerën e kërkuar, ju sqarojmë se e njëjta është e pa bazuar. Kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë “1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme ndërtim i lartë brenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë. Kontratat e paraqitura (natyrës se ngjashme) duhet të paraqesin vlerën e se paku 7,000,000.00 Euro. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “1. Një listë (tabelë) e cila paraqet kontratat të ngjashme të përfunduara brenda 3 (tri) viteve të shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë duhet të paraqesin vlerën e se paku 7,000,000.00 Euro, kontrata të natyrës se ngjashme duhet të specifikohet data e përfunduar, lloji i punëve të përfshirë, pranuesi i punëve, shuma financiare e kontratës, ku për secilin punë të paraqitur në listë duhet të këtë Dëshmi me shkrim (Referencë ose Certifikatë përfundimtare ose Raport pranimi teknik të punës). Për investitor privat kërkohet dëshmi si faturë tatimore apo transaksione bankare”. Autoriteti kontraktues nuk i ka analizuar në tërësi dëshmitë e prezantuara nga ana jonë si referencat dhe kontratat, pasi që të njëjtat kategorizohen tek ndërtimet e larta duke përfshirë këtu edhe renovimet, sepse edhe renovimet hyjnë në kuadër të sektorit të ndërtimit.*

### **Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues**

**Ekspertja shqyrtuese** pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE ankues gjenden listat e projekteve të përfunduara të ndara me vite që nga viti 2011, te cilat disa kanë dëshmi referencat, dhe rrjedhimisht bazuar në kërkesën e Autoritetit Kontraktues, projektet e përfunduara brenda tri viteve nga njoftimi për kontratë, si e tillë, listat e fundit të projekteve, të cilat merren nga njoftimi për kontratë 3 vitet e fundit i bie nga viti 31.12.2021, marrë parasysh se ne listë OE ankues posedon natyra të ndryshme të punëve, duke filluar me ndërtim, renovim, ndërtim i impianteve për ujërat e zeza (hidro) etj, dhe po ashtu bazuar në kërkesën në dosje të tenderit, OE në fjalë posedon projekte të natyrës së ngjashme të cilat gjithashtu përkojnë me natyrën e aktivitetit të prokurimit, të cilat AK në vlerësim ka mundur të kërkoj sqarime për projektet në listë. Pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

### **Pretendimi i dytë i OE ankues:**

*2. Në lidhje me arsyet e eliminimit për inxhinierët z. L. D., z. P. H. dhe z. G. K. ku është cekur që të njëjtit nuk e plotësojnë përvojën prej 7 viteve punë pas diplomimit, ju sqarojmë se edhe kjo arsye është e pa qëndrueshme. Për inxhinierët e lartcekur ne i kemi prezantuar dëshmitë e kërkuara sipas dosjes së tenderit dhe nëse të njëjtat analizohen në tërësi, atëherë shumë qartë kuptohet se inxhinierët e prezantuar nga ana jonë e plotësojnë kërkesën në lidhje me përvojën prej 7 viteve punë. Kërkojmë nga OSHP-ja që dëshmitë e ofruara nga ne, të vlerësohen drejtë sepse me këtë vlerësim të AK[1]së ne jemi diskriminuar, prandaj për të mos iu bashkangjitur me ankesë dëshmitë e tilla po iu inkurajojmë që të shikoni me kujdes dëshmitë e ofruara nga ne dhe më pastaj të vini në përfundim të drejtë dhe të saktë ju si institucion i pavarur. Kërkesa 6 e DT lidhur me Inxhinieri i Hidro teknikes z.L.D. ka diplomuar ne vitin 2016 dhe është prezantuar ne CV e tije përvoja nga 2016 deri 2024 qe ka dëshmi mbi 9 vite përvojë profesionale, te mbështetura me dokumentacion te kërkuar ne DT Kërkesa 8 e DT lidhur me Inxhinierin i Elektro-energjetikes z.P.H. ka diplomuar ne vitin 2009 dhe është prezantuar ne CV e tije përvoja nga 2009 deri 2024 qe ka dëshmi mbi 16 vite përvojë profesionale, te mbështetura me dokumentacion te kërkuar ne DT Kërkesa 9 e DT lidhur me Inxhinieri i makinerisë z.G.K. ka diplomuar ne vitin 2014 dhe është prezantuar ne CV e tije përvoja nga 2014 deri 2024 qe ka dëshmi mbi 10 vite përvojë profesionale, te mbështetura me dokumentacion te kërkuar ne DT Po ashtu nëse eventualisht AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me inxhinierët e prezantuar nga ana jonë, atëherë e njëjta ka mundur dhe është dashur të kërkoj sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.*

### **Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues**

**Ekspertja shqyrtuese** lidhur me arsyen e dytë të eliminimit si pretendim i OE ankues sqaron se, OE në fjalë në ofertë sa i përket inxhinierit të Hidros me inicialet L.D, i njëjti diplomën master e posedon nga viti 17/10/2016 për të cilin ka të bashkangjitura referencat i cili posedon më tepër përvojë, pra edhe para diplomimit, dhe si e tillë nëse kalkullohet përvoja nga data e diplomimit, i njëjti posedon rreth 9 vite përvojë punë, të cilat referenca janë nga disa kompani të ndryshme, kryesisht janë menaxhim dhe mbikëqyrje të punimeve në projekte të realizuara nëpër vite dhe muaj, andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht bazuar.

Inxhinieri i elektros me inicialet P.H, për të njëjtin gjendet diploma i cili ka mbaruar studimet me datë 23/12/2009 dhe në ofertë kanë bashkangjitur referenca mbi kryerjen e shërbimeve të inxhinierisë, menaxhim, mbikëqyrje në cilësi të inxhinierit të elektros, andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.



Tutje, inxhinieri i makinerisë me inicialet G.K i cili posedon diplomën master studimet e mbaruara nga viti 27/01/2014, i njëjti ka prezantuar referenca si përvojë në menaxhim, mbikëqyrje, profesor, hartim dhe projektim, etj, bazuar gjithashtu në CV i njëjti deklaroi se nga viti Prill 2018-Mars 2023 ka qenë edhe operator i zyrës projektuese-inxhinier i makinerisë termoelektrike tek Tregtia SHPK, po ashtu sipas certifikimit të inxhinierit si Auditor i energjisë në ndërtim me ne vitin 2023 i cili certifikim nuk mund të aplikohet pa poseduar fillimisht 5 vite përvojë pune pas diplomimit, dhe si e tillë referencat nga AK mund të verifikohen. Pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

#### **Pretendimi i tretë i OE ankues:**

*3.Në lidhje me arsyen e AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ku e njëjta e ka cekur se anulimi i aktivitetit të prokurimit bëhet edhe për shkak të tejkalimit të vlerës së parashikuar të tenderit, ju sqarojmë se ky arsyetim është i paqëndrueshëm, sepse kur analizohet paramasa dhe paralogaria e këtij aktiviteti të prokurimit kuptohet qartë se vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit në krahasim me punët të cilat do të kryhen në këtë aktivitet të prokurimit nuk janë në përputhje me njëra tjetrën, pasi që vlera e parashikuar është shumë e ulët. Nga analiza e paramasës dhe punëve të cilat duhet të kryhen dhe nga analiza e çmimeve të tregut për këto punë të përcaktuara në paramasë rezulton se vlera e parashikuar është bërë shumë gabim dhe shumë e ulët, kurse oferta jonë është shumë e përafërt me çmimet e tregut. Se parashikimi i vlerës për këtë tender është i pasaktë dhe shumë i ulët e tregon fakti edhe nga ofertat financiare të kompanive të tjera ofertuese. Ne nuk jemi bazuar në vlerën e parashikuar të tenderit por në çmimet reale të tregut kur kemi ofertuar, prandaj nuk duhet të pësojmë ne si kompani nëse është përcaktuar gabimisht apo në mënyrë të ngutshme vlera e parashikuar e tenderit.*

#### **Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues**

**Ekspertja shqyrtuese** lidhur me pretendimin e OE ankues i cili pretendim është edhe kyç lidhur me rivlerësimin apo anulimin e aktivitetit të prokurimit sqaron se, në E-prokurim gjendet Deklarata e nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, e cila deklaratë ka të përcaktuar vlerën e parashikuar në **5,505,000.00 EURO**, gjithashtu në deklarimin e disponueshmërisë së fondeve nga Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) sqarohet se:

## II.2 DISPONUSHMËRIA E FONDEVE

### II.2.1 Deklarata mbi disponueshmërinë e fondeve:

Zyrtari Kryesor Financiar "ZKF" duhet formalisht të sigurojë që fondet janë të disponueshme për prokurimin në fjalë.

[në rast të një autoriteti publik apo një organizate buxhetor]

Zyrtari Kryesor Financiar "ZKF" duhet formalisht të sigurojë që janë përvetësuar mjetet për prokurimin në fjalë në një shumë të mjaftueshme për të përmbushur obligimet financiare që mund të rrjedhin gjatë periudhës së vitit të tanishëm fiskal si rezultat i këtij prokurimi.

A është ky projekt shumë-vjeqar?

Po ☒

Jo ☐

II.2.2 Deklarata e mos-disponueshmërisë nga ndonjë autoritet tjetër publik (nëse AK është një Autoritet publik apo një organizate buxhetore):

[Deklarata]

Bazuar te projekt ligji për buxhet për vitin 2025 në tabelën 3.2 - Projekti 19335 ka buxhet 4,195,000.00€ ndërsa në kornizën afatmesme 2024-2027 ka buxhet total: 5,505,000.00 €. Bashkëngjitur tabela 3.2

Dhe si e tillë, **korniza afatmesme 2024-2027 ka buxhet total sa vlera e parashikuar 5,505,000.00 euro**, dhe në rastin konkret, operatorët ekonomik kanë aplikuar me çmime tepër të larta në krahasim me vlerën e parashikuar, kurse pretendimi i OE ankues lidhur me hulumtimin e tregut sa i përket çmimeve nga ana e AK-së, ky pretendim konsideroj se ka qenë e nevojshme që të parashtrohet si pyetje dhe sqarime në afat ligjor sipas nenit 53 të LPP-së për sqarim të dosjes së tenderit në fazën e kritereve, andaj si e tillë ekspertja shqyrtuese bazuar në përgjigjen e Autoritetit Kontraktues gjithashtu deklaratën e nevojave dhe deklarin e ZKF-se, ky aktivitet i prokurimit nuk mund të rekomandohet që të vazhdohet me rivlerësim, duke qenë se ofertat janë me një diferencë me minimum **34,195,397.00euro** ose **720 %** më të lartë se sa vlera e parashikuar e këtij aktiviteti të prokurimit.

**Si përfundim**, pretendimet e OE ankues lidhur me arsyen e eliminimit gjenden pjesërisht të bazuara, për faktin se referencat për projektet e përfunduara dhe referencat për përvojën e punës gjatë vlerësimit mund të sqarohen sipas nenit 72 të LPP-së ku AK mund të kërkojë vërtetim Trust-in ose referenca, po që se vlera e parashikuar dhe oferta të ishte në një vlerë. Mirëpo në rastin konkret sipas sqarimeve edhe në përgjigjen e dhënë në pretendimin e tretë, ekspertja shqyrtuese rekomandon që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, mirëpo të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues anulim i cili është i bazuar sipas dispozitave ligjore të LPP-së neni 62 dhe nenin 43.7 të Rregullores për prokurim Publik nr.001/2022 neni 43.7 germa b.

*43.7 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:*

*a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.*

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “CONSTRUMAX SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Institucionit Korrektues dhe Qendrës së Paraburgimit në Prizren” me numër të prokurimit: “33600-24-13625-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **CONSTRUMAX SH.P.K.**

**Blerina Huruglica**

